Viktima ishte kthyer nga Anglia pak kohë më parë/ Qiraxhiu ekzekuton pronarin e stallës së derrave. Para krimit ata...

Dec 18, 2020 | 11:06

SHPËRNDAJE Facebook Twitter

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur paraditen e djeshme në fshatin Goraj të Kuçovës, ku një 41-vjeçar u qëllua për vdekje nga një tjetër person.

Ngjarja ndodhi në oborrin e një lokali në fshatin Goraj, ndërsa viktimë mbeti shtetasi Ajet Guneli. Policia ka arrestuar autorin e dyshuar të krimit të rëndë, 44-vjeçarin Vangjel Polovina. Sipas uniformave blu, Polovina ka qëlluar ndaj 41-vjeçarit me breshëri kallashnikovi, duke e lënë të vdekur në vend.

Sherri mes tyre ka nisur për arsye banale, ndërsa herë pas here mësohet se kanë pasur keqkuptime mes tyre. Autori është shprehur gjatë shoqërimit të tij në Polici se kishte debate të vazhdueshme me shtetasin Ajet Guneli, pasi ai e ofendonte.

Ndërkohë, mësohet se autori i kishte marrë me qira një stallë derrash viktimës, çka edhe pretendohet se është kthyer në një mollë sherri mes tyre.

POLICIA

Policia e Beratit njoftoi paraditen e djeshme se e arrestoi në kohë rekord autorin e vrasjes së 41-vjeçarit. "Vrau me armë zjarri për motive të dobëta qiramarrësin e objektit, kapet dhe vihet në pranga 44-vjeçari. Shërbimet e Komisariatit të Policisë Berat, në bashkëpunim me strukturat hetimore të Drejtorisë Vendore të Policisë Berat dhe forcat e posaçme 'Shqiponja', pas njoftimit të marrë se te liqeni në afërsi të fshatit Goraj të Beratit kishte ndodhur një vrasje me armë zjarri, menjëherë kanë shkuar në vendngjarje.

Falë veprimeve të shpejta profesionale dhe hetimore, krehjes së zonës dhe reagimit të menjëhershëm duke rrethuar zonën në një perimetër të gjerë bënë të mundur kapjen dhe arrestimin e autorit të dyshuar të ngjarjes, shtetasin V. P., 44 vjeç, banues në Kuçovë.

Gjithashtu, shërbimet e Policisë kanë sekuestruar në cilësinë e provës materiale automjetin tip furgon me të cilin autori tentoi të largohej, si dhe armën e zjarrit kallashnikov me të cilën dyshohet se ka kryer krimin.

Ky shtetas, mëngjesin e sotëm (djeshëm), në oborrin e një lokali në liqenin e fshatit Goraj ka vrarë me armë zjarri, për motive të dobëta, shtetasin A. G., 41 vjeç, pasi kishte debate të vazhdueshme dhe pretendonte se ai e ofendonte përditë. Shtetasi V. P. i kishte marrë me qira një stallë derrash 41- vjeçarit dhe kishte mosmarrëveshje të vazhdueshme me të me të, pasi pretendonte se qiramarrësi e shante dhe ofendonte përditë.

Grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, ndodhet në vendngjarje dhe vijon puna për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes", njoftoi Policia pak pasi kishte ndodhur ngjarja.

DËSHMITARËT

Ndërkohë, banorët e zonës kanë treguar për mediat detajet se si ka ndodhur krimi i rëndë. Një banor i fshatit Goraj, mik i viktimës, ka treguar se Ajet Guneli kishte qenë për darkë një natë më parë në shtëpinë e tij, ndërsa theksoi se ai ishte një njeri shumë i mirë. Mes të tjerash, shoku i viktimës tha se nuk ishte në dijeni nëse kishte pasur ndonjë konflikt me autorin e dyshuar të ngjarjes, Vangjel Polovinën.

"Kur erdha unë çdo gjë kishte mbaruar. Unë erdha në dashamirësi. Erdha se e kam shok këtë që u vra, Ajetin. Mbrëmë ishte tek unë, hëngri bukë. Nuk di gjë për lidhjen e tyre, njihja vetëm Ajetin (qan). E pata mbrëmë në shtëpi, hëngri bukë me çunat e mi (qan), ishte një njeri shumë i mirë.

Kjo që ndodhi, ndodhi", tha i moshuari. Ndërkohë, një tjetër banor i fshatit Goraj është shprehur se kishte dëgjuar që autori kishte shkrepur një karikator në drejtim të 41-vjeçarit. "Më thanë se ishte derdhur një karikator i tërë, kështu më thanë", thotë një tjetër banor i kësaj zone që ndodhet në vendngjarje.

Viktima ishte kthyer nga Anglia pak kohë më parë

Viktima Ajet Guneli mësohet gjithashtu se ishte kthyer pak kohë më parë nga Anglia ku jetonte së bashku me familjen, për t'u marrë me disa dokumente në fshatin e lindjes, Goraj.

Ai i kishte dhënë me qira autorit të vrasjes një stallë derrash, por prej rreth 1 viti e gjysmë ky i fundit nuk i kishte paguar asnjë lekë. Viktima i kishte kërkuar disa ditë më parë lekët qiraxhiut, ndërsa kishin debatuar për këtë fakt. Dje në mëngjes, qiraxhiu ka pritur pronarin të shkonte te kafja e lokalit dhe pasi janë konfliktuar bashkë, 44-vjeçari ka qëlluar me breshëri kallashnikovi në drejtim të tij, duke e lënë të vdekur në vend. Autori është kapur nga Policia disa metra larg vendit të ngjarjes, në përpjekje për t'u larguar.

© Panorama.al

Subscribe

Për t'u bërë pjesë e grupit të "**Panorama**" mjafton të klikoni: **Join Group** dhe kërkesa do t'ju aprovohet.
KOMUNITETI PANORAMA ONLINE:
https://facebook.com/groups/panoramaonline/

Shfaq komente

Te lidhura

Koronavirusi mbërrin edhe në Antarktidë! Kjo do të thotë se...

Shkrimtari dhe gazetari italian i kthen Francës titullin "Legjioni i Nderit" pas dekorimit nga Macron të Presidentit egjiptian: Vendim i hidhur për shkak të...

Qeveria e Kosovës zbut disa masa kundër koronavirusit

INTERVISTA/ Nga ministre e Enver Hoxhës te ish-këshilltare e Blendi Çuçit, rrëfimi i fundit i Themie Thomait: Si më emëruan në 1976 pa më pyetur! Ç'më tha Hysni Kapo...

Lajm i mirë për Brojën, sulmuesi i Shqipërisë mposht 'COVID'-in

Opinion

Të jetosh në "Prillin e hidhur" të Bardhyl Londos
Dec 22, 2020
AGRON GJEKMARKAJ

Peshkimi dhe marrëveshja e BE me Britaninë. Palët, nën presionin e madh kohor
Dec 22, 2020
XHEZAIR ZAGANJORI

Liria e fjalës përkundrejt përmbajtjes së saj
Dec 22, 2020
DENION MEIDANI

Sa shumë borxh publik është shumë?
Dec 21, 2020
ARBEN MALAJ

Ulliri që do të përjetësojë ministeriumin e Drinit
Dec 21, 2020
PROF. DR. MENTOR PETRELA

JU REKOMANDOJMË boost

"Arkivolin e sollën pak minuta para varrimit dhe nuk na lejonin ta hapnim, por..."/ Dëshmia e
panorama.com.al

Vlerat e Propolisit për shëndetin. Antibiotik natyral. I duhuri për këtë periudhë që po kalojmë
mjekesia.org

hp
globe
KRIJUAR PËR TË BËRË GJITHÇKA
HP Laptop 15-da2000nia
74,790 lekë
Zbulo më shumë
intel CORE i5
Powered by Intel® Core™ i5 processor



EMRAT/ Zbardhet lista, ja kush janë 842 familjet fituese të
panorama.com.al

Paguaj faturën e dritave direkt nga celulari me aplikacionin
EasyPay

INTERVISTA/ Nga ministre e Enver Hoxhës te ish-
panorama.com.al

Mësoni sekretin e një fytyre pa rrudha Më Shumë
mjekesia.org



"Të mbys me këto duar"/ Vajza vjen nga Anglia të çmallet me familjen, por ka harruar
panorama.com.al

Mbroni organizmin dhe rrisni imunitetin me suplementin natyral Emune Propolis
mjekesia.org



FOTO/ U arrestua sot për vrasjen e çiftit Pasho, ja kush është 36-
panorama.com.al

Ndezim Ofertat e Dhjetorit!
Shop Mania

Kur pritet të vijë në Shqipëri vaksina anti-Covid në Shqipëri! Në
panorama.com.al

Paguaj faturen e ujit direkt nga celulari me aplikacionin EasyPay
EasyPay



Zbulohet personi i tretë për vrasjen e efektivit të FNSH/ Hetimet zbardhin veprimet e
panorama.com.al

Ofertat më fantastike që mund të imagjinoni.
Mercedes Benz



"Djali u shokua, mbante veshët mbyllur", si u vra
panorama.com.al

Ndezim Ofertat e Dhjetorit!
Shop Mania

Përhapja e Covid-it në Shqipëri/ Masa më të rrepta për lëvizjen e
panorama.com.al

Ndezim Ofertat e Dhjetorit!
Shop Mania

Na Kontaktoni

Adresa: Rr."Panorama" (prapa shkolles "Harry Fultz"). Nd.3, H.14, Ap.3, Njesia bashkiake nr.9, Kodi postar 1016, Tiranë.

Website: www.panorama.com.al
NIPT: K22112005E

Privacy Policy

Partnerët tanë

- Panorama Sport
- Hysenbelliu Group
- Revista Psikologji
- Birra Korca
- Universiteti Luarasi
- Erjoni Ndertim
- Hotel Prestige
- Restorant Prestige
- Uji Fab
- Omnifactor shpk

Na ndiqni

PËLQEJE
NA NDJEK
ABONOHU

© Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga Gazeta Panorama. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të Panorames. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi dhe publikimi i paautorizuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të Panorama-s. Shfrytëzimi i materialeve pa lejen e Grupit Panorama është shkelje e te drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin. Të gjitha të drejtat Gazeta Panorama